

RIFINITURA

GRATEX I LËNGSHËM AKRILIK



Ngjyra	Paketimi
E bardhë	Kovë, 25 Kg

PËRSHKRIM

Shtresë përfundimtare dekorative akrilike për përdorim fasadash të jashtme por edhe sipërfaqesh të brendshme. Ky produkt formon një strukturë të qëndrueshme, rezistente ndaj kushteve atmosferike si rrezeve të diellit dhe formimit të myqeve sepse lejon përshkueshmërinë e avujve. Është një produkt i thjeshtë në aplikim, me shtrirje dhe ngjitje shumë të mirë.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suporti ku do të aplikohet GRATEX paraprakisht duhet të pastrohet nga pluhurat si edhe mbetjet e naftës, dyllit dhe materialeve ngjitëse. Pastrimi i të sipërpërmendurave realizohet në mënyrë manuale. Suportet duhet të jenë të sheshta dhe mekanikisht të qëndrueshme. Përpara aplikimit të GRATEX suporti duhet të rrafshohet dhe të nivelohet me Ecoliner ose Bondex e me pas të lyhet me Astar Grafato.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për krijimin e veshjeve dekorative me cilësi mjaft të mirë hidroizoluese, ngjitëse dhe elastike. Përdoret për krijimin e veshjeve dekorative mbi sipërfaqe të mbushura me llaç çimentoje dhe llaç themelor termoizolues.



APLIKIMI

Produkti përziehet derisa të formohet një masë homogjene dhe lehtësisht e aplikueshme. Përzierja mund të bëhet me një përzierës elektrik me xhiro të ngadalta. Duhet treguar kujdes që përzierësi të jetë plotësisht i pastër nga mbetje pigmentesh të ndryshme për të shmangur çdo ndryshim në produktin e formuar. Aplikimi i produktit realizohet në mënyrë manuale nëpërmjet një malle dhe punohet në drejtim horizontal, vertikal ose rrethor në varësi të efektit estetik që dëshiron të realizosh. E gatshme për aplikim në formë paste, e bardhë ose me ngjyrë. E disponueshme në granulometri të ndryshme.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pastë	Koha e punueshmërisë: 20 min në 20°C
Paketimi: Kovë plastike 25 kg	pH i përzierjes: 8-9
Ngjyra: E bardhë	Forca ngjitëse: 0.4 MPa
Djegshmëria: I padjegshëm	Densiteti: 1,85 ± 0.05kg/lt
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C dhe lagështia relative më e ulët se 80%	Ruajtja: 24 muaj në paketim origjinal. Ruhet në vende të mbrojtura nga ekspozimi në diell. Mbrojeni nga ngricat.
Koha e tharjes: 24-48 orë në varësi të temperaturës dhe lagështisë së ambientit.	



Gjatë aplikimit të produktit duhet pasur kujdes që temperatura e ambientit të jetë më e madhe se 5°C dhe më e vogël se 35°C, ekspozimi direkt ndaj diellit, shiut, erës, lagështisë ndikojnë në ngjyrën dhe cilësinë e produktit.